



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Rasti: Bashkim me përrthithje ALPHA BANK SH.A / EFG EUROBANK SH.A)

Në datën 3 Tetor 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet palëve (ALPHA BANK SH.A / EFG EUROBANK SH.A). Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve është nënshkruar më datë 29 Gusht 2011 me objekt bashkimin me përrthithje të Alpha Bank SH.A me Eurobank SH.A.

Veprimtaria e Palëve pjesëmarrëse

- **Alpha Bank SH.A** : një bankë e regjistruar sipas legjislacionit grek , që ofron një gamë të gjerë shërbimesh, përfshirë shërbime bankare për individët, shërbime bankare për korporatat, manaxhim aktivesh, shërbime bankare private, shpërndarje sigurimi, qera financiare, faktoring, brokerim etj.
- **Eurobank SH.A**: është një nga bankat kryesore në Greqi e cila ofron shërbime bankare për individët, shërbime bankare për bizneset e vogla dhe të mesme, bankë investimi, shërbime të tregut kapital, shërbime bankare private dhe manaxhim aktivesh.

Aktiviteti i palëve pjesëmarrëse në transaksion shtrihet në rajonin e Evropës Juglindore ndërkohë që në Shqipërie është prezent nëpërmjet degës së saj të licensuar nga Banka e Shqipërisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është përqendrim në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al